



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0009467/26 dt. 19.02.2026

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për të premtën më dt. **27.02.2026**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa
(Mbledhja e 2-të)

Mbledhja do të ketë këtë REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim vendim për formimin e komiteteve konsultative
3. Propozim vendim për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës
4. Raporti financiar i komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Mediave duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0004429/26 dt. 30.01.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa
Mbledhja e 1-rë

Koha: 30.01.2026 ora 14:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Majlinda Kurti, Igballe Islami, Valon Brahimi, Erseka Barani, Kushtrim Zeneli dhe Visar Syla

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, paragrafi 2 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë; nenit 62, paragrafi 1 dhe 2, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, nenit 13, të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës Nr. 12/2013, për sot kam thirrur mbledhjen e parë të Komitetit për Politikë dhe Financa me rendin e ditës të paraparë me thirrje si në vijim:

1. Propozim vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve
2. Propozim vendim për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026
3. Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
4. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
5. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
6. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik
7. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit
8. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
9. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore
10. Propozim vendim për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026
11. Propozim vendim për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave
12. Propozim vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Uniteti"

13. Propozim vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunksionale"
14. Propozim vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A.
15. Propozim vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu"
16. Propozim vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve
17. Propozim vendim për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026
18. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025

Në vazhdim Kryesuesi theksoi se në mbledhje të jashtëzakonshme plotësim-ndryshim të rendit të ditës nuk ka, por dua ta jap një sqarim te pika 17., paraprakisht jemi dakorduar që kjo pikë të hyjë në rend dite, por në ndërkohë pasi që unë e kam nënshkruar rendin e ditës, materiali për këtë pikë nuk ka qenë gati me arsyetimin se duhet të kemi një analizë më të detajuar rreth kësaj çështjeje, për këtë arsye materiali nuk na ka ardhur, por me qenë se është në rend dite kjo pikë duhet të miratohet në rend dite, ndërsa kur të vije radha për shqyrtim e diskutim, kjo pikë mund të kalohet për një seancë tjetër. Prandaj, hap diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Igballe Islami: Para se të fillojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës dhe arsyetimit që ju e dhatë për pikën 17., unë në asnjë mënyrë nuk pranoj me diskutuar e aq më tepër me aprovuar një pikë të rendit të ditës për të cilën nuk kemi material mbështetës e sidomos kur kemi një pikë kaq të rëndësishme siç është dhënia në shfrytëzim e pronave. Para kësaj pike unë kam edhe një problem të cilin unë e konsideroj se nuk është vetëm obligim administrativ por mbi të gjitha është ligjor, ku të gjitha materialet që i kemi pranuar për këtë mbledhje asnjëra nuk e ka protokollin zyrtar të Komunës. Nuk e kam çështjen vetëm me këto pika të rendit të ditës, sepse këtu kemi të bëjmë me komitete që janë obligative që duhet të krijohen si trupa mbështetëse të Kuvendit, mirëpo unë e kam për pikat e radhës që i kemi në mbledhje, protokollin zyrtar është ai që definon saktësisht dokumentin zyrtar, kur është regjistruar në Sekretari dhe kur është adresuar si material për Komitetin për Politikë dhe Financa. Vula dhe protokollin janë ato që dokumentet i bëjnë zyrtare dhe të qasshme për me i diskutuar. E di që këto janë komitete obligative dhe që duhet të krijohen si trupa mbështetëse të Kuvendit, mirëpo, dilema ime është nëse këto dokumente janë zyrtare për t'u shqyrtuar nga ne. Një çështje tjetër është se, tek pika e Komitetit për Siguri dhe Bashkësi, kjo është iniciuar nga Sekretaria përmes Kryetarit. Kjo krijon paqartësi mes kompetencave të ekzekutivit dhe legjislativit, sepse nuk është e qartë nëse është iniciativë e ekzekutivit apo iniciativë e Sekretarisë dhe e neve si Kuvend. Prandaj, këto janë dilemat e mija që nuk kanë të bëjnë me çështje politike, por me çështje administrative dhe ligjore. Qëllimi im është i qartë që Komiteti për Politikë dhe Financa të mos jetë vetëm një filtër formal, që vetëm të kalohen pikat dhe pastaj të diskutohet në Kuvend. Unë e praktikoj këtë: me qenë se jemi të zgjedhur, jemi të deleguar nga partia jonë, pse mos t'i filtrojmë dokumentet saktësisht në mënyrë administrative dhe ligjore dhe të mos bie përgjegjësia mbi neve si anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryetari Faton Peci: Është mirë që lidhur me këtë çështje të ipet një sqarim nga Sekretaria e Kuvendit.

Nazmi Jashari: Të gjitha pikat që janë propozuar në rendin e ditës, faktikisht janë proceduar nëpërmjet Sekretarisë. Kemi të bëjmë me formim të trupave punuese të Kuvendit, komiteteve që formohen nga Kuvendi. Të gjitha pikat që kanë të bëjnë me trupat e Kuvendit janë të proceduara nga Kryesuesi i Kuvendit. Pikat tjera që duhet proceduar nga Kryetari i Komunës janë të proceduara nga

Kryetari i Komunës. Formimi i komisioneve të aksionarëve të katër ndërmarrjeve janë proceduar nga Kryetari i Komunës. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili udhëhiqet nga Kryetari, është i proceduar nga Kryetari. Meqenëse materiali është përgatitur nga Sekretaria e Kuvendit, është shkruar nga Sekretaria përmes Kryetarit, domethënë procedohet përmes Kryetarit. Të gjitha këto pika do të marrin faktikisht protokollin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe do të ndahen si zakonisht në protokollin e brendshëm, pika e parë \ një, dy, tre, katër. Dilema ka qenë se një pikë do të tërhiqet nga rendi i ditës dhe për këtë arsye nuk është futur në protokoll në këtë fazë, sepse gjatë shqyrtimit u pa që pika për dhënien në shfrytëzim të pronave publike do të hiqet nga rendi i ditës, edhe pse e përmendi edhe Kryesuesi tek mbledhjet e jashtëzakonshme, rendi i ditës mund të diskutohet, por nuk mund të plotësohet apo ndryshohet. Ose miratohet si i tillë, ose nuk miratohet fare. Këtë çështje ju, si anëtarë më të vjetër të Komitetit, e dini shumë mirë. Në mbledhjet e jashtëzakonshme, rendi i ditës miratohet pa plotësime dhe pa ndryshime.

Valon Brahimi: Përshëndetje Kryesues, Kryetar, drejtorë të nderuar. Për mua është kënaqësi që sot jemi këtu dhe dua të t'iu uroj të gjithëve për punën. Unë i kam vërejtjet e mia, me gjithë respektin për Sekretarinë e Kuvendit e cila vazhdimisht ka bërë një punë të mirë, nuk po flas në aspektin politik, por po vlerësoj se çështja që lidhet me mungesën e bashkëngjijtes së protokollit propozim-vendimeve përbën shkelje procedurale dhe si e tillë kisha kërkuar prej Kryesuesit që të gjitha pikat të shtyhen për mbledhjen e radhës, sepse kjo mund të implikojë problem ligjor pastaj në MAPL nëse kalojnë në Kuvend, sepse ata në MAPL kur i vlerësojnë aktet e ligjshmërisë i shqyrtojnë edhe procesverbalet dhe nëse ka shkelje procedurale, ato mund të sjellin pasoja më vonë. Po flas me mirëkuptim dhe pa tendencë. Shikoni këtë dokument në të kaluarën, ka vulë dhe protokoll, ndërsa dokumentet e proceduara për shqyrtim disa nuk kanë vulë e nuk kanë as protokoll. Unë e kisha propozuar që me mirëkuptimin e të gjithëve, këto pika të shtyhen për një seancë tjetër dhe të vijnë të plotësuara, në mënyrë që mos të kemi probleme ligjore dhe procedurale, sepse të gjitha këto vendime do të shkojnë në MAPL për konfirmim të ligjshmërisë. Një dokument që nuk ka protokoll, përbën shkelje procedurale. Nëse një propozim nuk është i regjistruar në zyrën e protokollit dhe vjen pa protokoll në një organ kaq të madh siç është Komiteti për Politikë dhe Financa, nuk vlerësoj se duhet me kaluar pa këto plotësime. Unë propozoj Kryesues që, nëse dakordoheni të gjithë, këto pika të rendit të ditës të shtyhen për një seancë tjetër, në mënyrë që të eliminohen defektet procedurale dhe ligjore dhe të kemi siguri më të madhe kur të shkojnë në Kuvend, në mënyrë që aktet që shkojnë në Ministri mos me na u kthyer opinion negativ. Ky është vlerësimi im dhe është çështje e Kryesuesit dhe e gjithë anëtarëve të Komitetit se si do të veprojnë.

Kryesuesi Safet Kamberi: Këto janë pika për shqyrtim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe vendimet e KPF-së nuk shkojnë për interpretim ligjor në MAPL, sepse ky komitet është vetëm një filtër që i përcjell pikat tek Kuvendi. Vendimet e Kuvendit i nënshtrohen vlerësimit të ligjshmërisë nga ministritë përkatëse. Lidhur me çështjet që i cekët, nëse në të kaluarën ka pasur kështu praktika, kjo nuk do të thotë që duhet të vazhdojmë me të njëjtën praktikë. Unë besoj që herëve të tjera, bashkë me Sekretarinë, këto mangësi do të eliminohen dhe nuk do të kemi situata të tilla. Por nuk e shoh të arsyeshme që në këtë seancë të shtyhen të gjitha pikat e rendit të ditës për një seancë tjetër për këtë çështje. Ndërsa sa i përket pikës 17, nuk bëhet fjalë që kjo pikë të vije drejt në Kuvend, kjo pikë së pari do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa e pastaj vije në Kuvend. Për këtë pikë e marr unë përgjegjësinë se ka qenë një nguti e imja e jo e ekzekutivit. Unë e kam nënshkruar thirrjen më herët, sepse e kam vlerësuar se është çështje urgjente për shkak të afateve të dhëna nga Ministria.

Kushtrim Zeneli: Sa i përket çështjes që po diskutohet, ne e kemi një thirrje të mbledhjes që e ka një protokoll zyrtar, e ka nënshkrimin e Kryesuesit të Kuvendit dhe e ka vulën, e shtojmë edhe pjesën që kjo thirrje është bërë zyrtarisht përmes e-mailit zyrtar, prandaj kjo e dëshmon se thirrja dhe materiali janë zyrtare. Ju që keni qenë më herët në Komitetin për Politikë dhe Financa e dini se asnjë

pikë e KPF-së nuk ka shkuar për konfirmim të ligjshmërisë në MAPL. E dyta, diskutimi final dhe vendimet nuk i merr KPF-ja, vendimet merren në Kuvend, pastaj shkojnë për verifikim të ligjshmërisë në MAPL.

Kryetari Faton Peci: Ne kemi pasur dilemat edhe në komunat e tjera dhe e dimë që për komunat që kanë qenë në mandat afati 31 dhjetor është dita e fundit për miratimin e Listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026. Meqenëse jemi qeverisje e re, Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal ka dhënë një afat shtesë deri më 31 mars. Në anën tjetër ne kemi parë se disa vendime të disa prej komunave nga MAPL janë refuzuar për shkak të mungesës së qartësisë së propozimeve. Në mënyrë që ne të evitojmë një lëshim të tillë, unë kam kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës të përgatitet sa më mirë në mënyrë që mos të hasim në vërejtjet ose eventualisht kthimin mbrapa për aspekte ligjore dhe procedurale. Rrjedhimisht, pika shtatëmbëdhjetë, në momentin kur ne jemi në këtë pikë vetëm shtyhet për seancën e radhës dhe nuk vije në shprehje që të tentohet të aprovet pa u respektuar të gjitha afatet ligjore, kohore dhe administrative.

Valon Brahimi: Vetëm një sqarim, unë këtu po flas për një çështje tjetër. Unë vetëm e shpreha si shqetësim mungesën e protokollit të dokumentet, e di që KPF nuk merr vendim, por kur këto pika shkojnë prej KPF-së në Kuvend dhe pastaj t'i nënshtrohen konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL, MAPL si shkallë e dytë që nga ai moment mund të kërkoj dokumente çfarë të dojë lidhur me këto pika e ne nuk mund t'ia ndalim.

Kryesuesi Safet Kamberi: Shqetësimet janë korrekte dhe kemi nevojë që t'i trajtojmë seriozisht. Realisht, ne kemi mundur ta thërrasim seancën e Kuvendit edhe pa Komitet, por është zgjedhur rruga përmes Komitetit për Politikë dhe Financa. Kjo është bërë për të respektuar procedurat. Në Kuvend, çdo anëtar mund të propozojë një pikë të rendit të ditës, por lind pyetja: ku është protokoli i asaj pike për të vazhduar tutje në procedurë? Këto pika realisht kanë qenë të përgatitura nga Sekretaria. Disa prej tyre duhet të shkojnë përmes Kryetarit, dhe kanë ardhur përmes Kryetarit, ndërsa pjesa tjetër kanë ardhur përmes Kryesuesit. Në këtë drejtim nuk ka asnjë problem. Atëherë, kush është që seanca e KPF-së të vazhdojë me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Rendi i ditës u miratua me shumicë votash (6 për, 0 kundër dhe 1 abstenim).

Pika 1

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 2

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026 u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi i mbledhjes propozoi që pikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të diskutohen përnjëherë ndërsa votimi të bëhet ndaras.

Komiteti për Politikë dhe financa unanimisht u pajtuan me propozimin e Kryesuesit.

Pikat: 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 10

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026 u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 11

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi i mbledhjes po ashtu propozoi që pikat 12, 13, 14 dhe 15 të diskutohen për njëherë ndërsa votimi të bëhet ndaras.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht u pajtuan me propozimin e Kryesuesit.

Pikat: 12, 13, 14 dhe 15

Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin.

Valon Brahimi: Në mandatin e kaluar në komisionet komunale të aksionarëve të katër ndërmarrjeve janë përfaqësuar të gjitha partitë dhe është respektuar kuota gjinore, prandaj kërkoj që kjo praktikë të vazhdoj tutje.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Uniteti".

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Uniteti" u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunksionale".

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunksionale" u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A., u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu".

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu" u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 16

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 17

Komiteti për Politikë dhe Financa vendosën që Propozim vendimi për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026 të shtyhet për mbledhjen e radhës së KPF-së.

Pika 18

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Raportin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025 u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 14:55 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesi i Kuvendit

Merita PRETENI

Safet KAMBERI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATË/A:	19.02.2026
REFERENCË:	Nr. 01-060/01-0009457-2/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci– Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi – Kryesuese e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim Vendim Për formimin e komiteteve konsultative

Në bazë të neneve 12, paragrafi 2, pika d, 51 paragrafi 2 dhe 58 pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; neneve 13, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, 61 paragrafi 2 dhe 77 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenit 4, të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 Për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna; Kuvendit të Komunës i propozoj të sjell këtë:

Propozim-vendim
Për formimin e komiteteve konsultative

- Me qëllim që qytetarët dhe grupet tjera të interesit të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes për interes publik të Komunës, Kuvendit të Komunës i propozoj FORMIMIN e komiteteve konsultative si në vijim:
 - Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara,
 - Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
 - Komiteti për Planifikim Urban, Mbrojtje të Ambientit, Shërbime Publike dhe Zhvillim Ekonomik.
- Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime nga fushë veprimtaritë e tyre në pajtim me Statutin e Komunës, përfshirë:
 - Dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme,
 - Hulumtime të ndryshme,
 - Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse,
 - Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës,
 - Japin propozime për zgjedhjen e problemeve të identifikuara.
- Propozimet nga pika 2 të këtij vendimi duhet të merren parasysh nga Kuvendi i Komunës për zhvillimin politikave lokale.
- Komitetet përbehen nga 5 deri 7 anëtarë dhe duhet të reflektojnë përfaqësimin gjinor.
- Kuvendi i Komunës shpall konkurs publik për anëtarësimin e anëtarëve në këto komitete konsultative, konkursi përcakton kushtet dhe kriteret e konkurrimit.
- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Mitrovicës dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

7. Kandidati i cili konkurren që të bëhet anëtar i këtyre komiteteve konsultative duhet të jetë qytetar i Komunës së Mitrovicës dhe të ketë përvojë profesionale për pjesëmarrje në konsultime për fushën për të cilën themelohet komiteti konsultativ.

8. Me këtë propozim-vendim propozohet formimi i Panelit përzgjedhës në përbërje prej pesë anëtarëve, tre anëtarë të Kuvendit të Komunës, një anëtar nga ekzekutivi i Komunës dhe një anëtar nga shoqëria civile. Paneli përzgjedhës në bazë të rezultateve të konkursit, do t'i propozojë Kuvendit të Komunës listën me anëtarët për komitetet konsultative;

8.1 _____

8.2 _____

8.3 _____

8.4 _____

8.5 _____

9. Kuvendi i Komunës, në bazë të listës së propozuar nga Paneli përzgjedhës, me vendim emëron anëtarët e këtyre komiteteve konsultative, të cilët nga përbëja e anëtarëve zgjedhin kryesuesin.

10. Mandati i anëtarëve të këtyre komiteteve konsultative është 4 (katër) vjeçar.

11. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATË/A:	19. 02. 2026
REFERENCE:	Nr. 02-060/01-009467-3/26
PËR/ZATO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi – Kryesuese e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim-vendim Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, nenit 32 dhe 58 pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 13, paragrafi 1 nenparagrafi 1.4, 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 dhe 77 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020, dhe duke u mbështet në nenin 4 paragrafi 4.3 të Statutit të Asociacionit të komunave të Kosovës, Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

Propozim Vendim

Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës

- Me këtë propozim-vendim propozohet të zgjedhën përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës në Asociacionin e Komunave të Kosovës në përbërje si në vijim:
 - 1) Faton Peci - Kryetar i Komunës
 - 2) _____ Anëtar i Kuvendit të Komunës
 - 3) _____ Anëtar i Kuvendit të Komunës
 - 4) _____ Anëtar i Kuvendit të Komunës
- Kuvendi i Komunës do t'i zgjedh përfaqësuesit për Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës në proporcion me numrin e votave që subjektet politike i kanë fituar në Kuvendin e Komunës, por edhe përfaqësimi i minoriteteve.
- Me këtë vendim të njoftohet Asociacioni i Komunave të Kosovës.
- Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Mitrovica Juzna– Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	30.01.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Safet KAMBERI – Kryesues i Kuvendit Komunal
KOPJE :	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Faton PEÇI – Kryetar i Komunës së Mitrovicës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Financiar Janar - Dhjetor 2025



Të nderuar/a,

Kryetari i Komunës, në kuadër të përpjekjeve për transparencë, respektim të legjislacionit në fuqi dhe bashkëpunim me Anëtarët e Kuvendit, ju prezanton:

**RAPORTIN FINANCIAR TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2025**

Si gjithmonë, jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe për ofrimin e sqarimeve shtesë, në rast se kërkohen.

Shënim: Zyrtarët e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa mbajnë të drejtën e plotësimit dhe ndryshimit të këtij raporti në rast të ndryshimit të gjendjes në SIMFK.

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës

Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

RAPORT FINANCIAR

PËR REALIZIMIN E BUXHETIT KOMUNAL

JANAR – DHJETOR

2025

<https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/>



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
1. TË HYRAT VETANAKE.....	4
1.1 Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale	4
1.2 Krahësimi i inkasimit të të Hyrave Vetanake me Planifikimin sipas Drejtorive.....	4
2. BUXHETI DHE SHPENZIMET	5
2.1 Shpalosja e Buxhetit	5
2.2 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave.....	6
2.3 Paga dhe Shtesa	7
2.4 Mallra dhe Shërbime.....	7
2.5 Shpenzime Komunale.....	8
2.6 Subvencione dhe Transfere.....	9
2.7 Investime Kapitale	9
3. Shpalosja e shpenzimeve sipas programeve/nëprogrameve në kategori ekonomike	10
3.1 Paraqitja grafike e shpenzimeve të buxhetit sipas programeve/nënprogrameve buxhetore	14
3.2 Shpalosja e shpenzimeve në Investime Kapitale	15
4. RAPORTI I TË ARKËTUESHMËVE.....	17
5. OBLIGIMET FINANCIARE - BORXHET	17
6. OBLIGIMET KONTRAKTUALE – DHJETOR 2025	18
7. DETYRIMET KONTIGJENTE	24
8. LËNDËT E EKZEKUTUARA NGA MINISTRIA E FINANCAVE – DEPARTAMENTI I THESARIT.....	25



HYRJE

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), neni 45, paragrafi 4, Kryetari i Komunës është i obliguar të përgatisë dhe t'i paraqesë Kuvendit Komunal raportet periodike dhe vjetore financiare për vitin fiskal. Në këtë kuadër, raporti financiar publikohet në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe një kopje e tij i dorëzohet Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve pas përfundimit të çdo tremujori.

Qëllimi i këtij raporti është informimi i Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit të Drejtorëve, mediave dhe publikut të gjerë lidhur me ekzekutimin e buxhetit të Komunës së Mitrovicës për vitin 2025.

Buxheti fillestar i Komunës për vitin 2025 është miratuar në bazë të LIGJIT NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025, përfshirë ndryshimet dhe plotësimet gjatë vitit fiskal.

Sipas vlerësimit tonë, ky raport financiar paraqet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme gjendjen financiare, performancën buxhetore dhe transaksionet financiare të Komunës së Mitrovicës për periudhën raportuese, në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MFPT-së.

Vërejtjet dhe rekomandimet e Kuvendit Komunal dhe të palëve relevante do të merren parasysh me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së raportimit financiar dhe transparencës buxhetore.



1. TË HYRAT VETANAKE

1.1 Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale

- Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin fiskal 2025 është në shumën prej 3,615,495.00 Euro, sipas LIGJIT NR. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025 përfshirë të gjitha plotësimet dhe ndryshimet e tij.
- Shënim:** Të hyrat nga dënimet në trafik, gjobat e gjykatave, si dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve nuk inkasohen drejtpërdrejt nga Komuna apo institucionet nën menaxhimin e saj.

1.2 Krahاسimi i inkasimit të të Hyrave Vetanake me Planifikimin sipas Drejtorive

	Drejtoria	Realizimi - 2025	Plani - 2025	% inkasimit të Planit Vjetor
1	Administrata	78,837.54	95,000.00	82.99%
2	Integrimet Evropiane	40,200.00	40,000.00	100.50%
3	Inspeksioni	14,297.50	13,000.00	109.98%
4	Buxhet dhe Financa	1,411,896.55	1,278,882.00	110.40%
5	Bujqësia	-	7,070.00	0.00%
6	Pylltari dhe Inspeksion	81,149.39	79,000.00	102.72%
7	Zhvillimi Ekonomik	14,925.00	27,000.00	55.28%
8	Gjeodezi dhe Kadastër	248,026.29	335,000.00	74.04%
9	Urbanizmi	1,367,562.81	1,531,643.00	89.29%
10	Sherbimet Sociale	4,980.00	3,800.00	131.05%
11	Sherbimet Kulturore	3,258.00	2,100.00	155.14%
12	Sherbimet e Kujdesit Primar	32,081.50	40,000.00	80.20%
13	Çerdhja e Fëmijëve	102,038.00	100,000.00	102.04%
14	SHMT Arkitekt Sinani	22,791.00	35,000.00	65.12%
15	SHME Hasan Prishtina	20,419.00	25,000.00	81.68%
16	SHMM Xheladin Deda	-	3,000.00	0.00%
17	Denimet e Policise	444,483.00		
18	Gjobat nga Gjykatat	98,050.00		
19	Agjensioni i Pyjeve	711.58		
	TOTALI	3,985,707.16	3,615,495.00	110.24%

Tabela 1



2. BUXHETI DHE SHPENZIMET

2.1 Shpalosja e Buxhetit

- Buxheti fillestar i aprovuar sipas ligjit nr 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 është në shumën totale prej 30,240,512.00 € ku Granti merr pjesë me 26,625,017.00 € ndërsa nga Të Hyrat Vetanake në shumën prej 3,615,495.00 €. Plani i të Hyrave Vetanake për vitin fiskal 2025 është tejkaluar për 370,212.16 €.
- Bartja e THV të pa shpenzuara gjatë vitit 2024 në vitin 2025 është në vlerën prej 867,555.29 €:
 - 5,000.00 € - Paga dhe Shtesa
 - 295,000.00 € - Mallra dhe Shërbime
 - 159,594.79 € - Subvencione dhe Transfere
 - 407,960.50 € - Investime Kapitale.
- Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës 03/261 të dates 05.06.2025, për Harmonizimin e Buxhetit në kategorinë ekonomike të Pagave dhe Shtesa (111) në Komunën e Mitrovicës janë shtuar **710,333.66** Euro të shpërndara nëpër Nënprograme.
- Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës 02/281 të dates 24.12.2025, për Harmonizimin e Buxhetit në kategorinë ekonomike të Pagave dhe Shtesa (111) në Komunën e Mitrovicës janë shtuar **44,019.59** Euro në Arsim Fillor.
- Grantet e Donacioneve të brendshme dhe të jashtme të pranuar gjatë vitit 2025 janë në shumën prej **246,399.97** €. Ndërsa nga viti i kaluar janë bartur **91,964.11** €.
- Buxheti final për vitin 2025 i Komunës së Mitrovicës, ka qenë **32,200,784.63** €.
- Raporti është bazuar në ndarjet e Ligjit 08/L-332 të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe të raporteve të gjeneruara nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK).



2.2 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave

	2025			2024		
	Realizimi	Buxheti Aktual	Index %	Realizimi	Buxheti Aktual	Index %
BURIMET E FONDEVE - PRANIMET						
Granti qeveritar	26,311,758.28	27,379,370.26	96 %	25,409,605.62	26,333,046.34	96 %
Të hyrat vetanake	2,906,772.66	3,615,495.00	80 %	2,431,928.57	3,288,173.99	74 %
Të hyrat vetanake 22	716,926.00	867,555.29	83 %	1,066,226.31	1,179,238.22	90 %
Grantet e përcaktuara të donatorëve	158,150.80	338,364.08	47 %	31,388.87	120,602.90	26 %
Gjithsej	30,093,607.74	32,200,784.63	93 %	28,939,149.37	30,921,061.45	94 %
KATEGORITE EKONOMIKE - PAGESAT						
Paga dhe rroga	16,822,997.90	16,893,699.86	100 %	17,487,299.06	17,504,585.27	100 %
Mallra dhe shërbime	4,584,708.04	5,137,151.73	89 %	3,824,127.00	4,208,549.59	91 %
Shpenzime komunale	538,312.25	600,000.00	90 %	423,501.64	616,801.17	69 %
Transfere dhe subvencione	1,237,940.93	1,398,518.24	89 %	1,403,498.40	1,446,256.16	97 %
Shpenzime kapitale	6,909,648.68	8,171,414.80	85 %	5,800,723.27	7,144,869.26	81 %
Gjithsej	30,093,607.80	32,200,784.63	93 %	28,939,149.37	30,921,061.45	94 %

Tabela 2

Shënim: Të dhënat e prezantuara në tabelën nr.2 janë të dhëna të gjeneruara nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK) dhe përfshijnë të gjitha Fondet Burimore të Organizatës Buxhetore 642 - Komuna e Mitrovicës.



2.3 Paga dhe Shtesa

Përshkrimi	Shuma €
11111 - PAGANETO	13,197,016.51
11121 - TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	890,181.67
11131 - KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	800,418.38
11151 - SINDIKATAT	36,889.81
11152 - ODAT PROFESIONALE	10,408.64
11211 - PËRVOJA E PUNËS	710,217.11
11311 - KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	800,102.54
11411 - SHTESA E VEÇANTË PËR TË ZGJEDHURIT	34,461.83
11415 - SHTESA PËR PUNËN PA ORAR TË PARACAKTUAR	2,893.30
11416 - SHTESA PËR VËLLIMIN E PUNËS	7,556.42
11418 - SHTESA PËR NËPUNËSEN/IN E SISTEMIT SHËNDETËSOR	32,389.04
11431 - KUJDESTARIA, PUNA GJATË NATËS & PUNA JASHTË ORARIT TË PUNËS	273,822.03
11432 - FUNKSIONET SHITESË	5,221.77
11611 - SHTESAT TRANZITORE	9,201.97
11900 - VENDIMET GJYQËSORE	12,216.88
Totali i Paga dhe shtesa	16,822,997.90

Tabela 3

2.4 Mallra dhe Shërbime

Pershkrimi	Shuma €
13132 - AKOMODIMI PËR UDHËTIMET ZYRTARE BRENDA VENDIT	1,477.95
13140 - TRANSPORTI PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	598.99
13141 - PARA XHEPI/MËDITJET PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	4,296.40
13310 - INTERNETI	3,960.58
13320 - TELEFONIA MOBILE	10,251.99
13330 - SHËRBIMET POSTARE	18,519.90
13410 - SHËRBIMET E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT	23,128.00
13420 - SHËRBIMET E PËRFAQËSIMIT PËR AVOKATURË	8,496.00
13430 - SHËRBIMET E NDRYSHME SHËNDETËSORE	92,243.60
13445 - SHËRBIMET E VEÇANTA - KONSULENTË DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL	11,060.94
13450 - SHËRBIMET E SHËTYPJES/PRINTIMIT	24,210.06
13460 - SHËRBIMET KONTRAKTUESE TË TJERA	788,616.20
13470 - SHËRBIMET TEKNIKE	44,137.29
13475 - SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE PUBLIKE	150,731.95
13480 - SHPENZIMET E ANËTARËSIMIT	37,650.00
13501 - MOBILJET	203,241.43
13503 - KOMPJUTERËT	83,899.38



13504 - PAJISJET E TJERA TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE TË KOMUNIKIMIT	9,851.27
13506 - PAJISJET SPECIALISTIKE MJEKËSORE	3,559.00
13509 - PAJISJET E TJERA	147,688.36
13511 - PAJISJET SPORTIVE	4,526.00
13610 - FURNIZIMET PËR ZYRË	98,133.87
13611 - FURNIZIMI ME DOKUMENTE BLLANKO	23,599.90
13615 - FURNIZIMI ME USHQIM PËR KAFSHË	170.00
13616 - FURNIZIMI ME ARTIKUJ BUJQËSOR	7,212.60
13620 - FURNIZIMI ME USHQIM DHE PIJE (JO DREKA ZYRTARE)	59,667.33
13630 - FURNIZIMET MJEKËSORE	238,717.41
13640 - FURNIZIMET E PASTRIMIT	76,525.10
13650 - FURNIZIMI ME VESHMBATHJE	25,092.94
13660 - AKOMODIMI PËR MIKPRITJE TË DELEGACIONEVE TË JASHTME	575.00
13710 - VAJI	33.00
13720 - NAFTA PËR NGROHJE QENDRORE	106,466.53
13760 - DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE	214,216.71
13780 - DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI	50,000.91
13950 - REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	14,261.32
14010 - MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE	27,166.18
14020 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE TË BANIMIT	3,605.00
14022 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ADMINISTRATIVE DHE AFARISTE	33,396.89
14023 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ARSIMORE	104,821.84
14024 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE SHËNDETËSORE	59,954.04
14026 - MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SPORTIVE	940.00
14032 - MIRËMBAJTJA E RRUGËVE LOKALE	722,589.69
14040 - MIRËMBAJTJA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE TË KOMUNIKIMIT	1,441.25
14050 - MIRËMBAJTJA E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE	74,131.16
14060 - MIRËMBAJTJA RUTINORE	488,303.86
14110 - QIRAJA PËR NDËRTESA	20,000.00
14120 - QIRAJA PËR TOKË	1,342.40
14310 - KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDIA VENDIT	117,342.88
14410 - VENDIMET GJYQËSORE	342,824.94
14450 - PAGESAT - GJOBAT NDËRINSTITUCIONALE	30.00
Totali i Mallra dhe Shërbime	4,584,708.04

Tabela 4

2.5 Shpenzime Komunale

Përshkrimi	Shuma €
13210 - ENERGJIA ELEKTRIKE	412,615.27
13220 - SHËRBYMET E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT	66,175.78
13230 - MBETURINAT	40,301.66
13250 - TELEFONIA FIKSE	19,219.54
Totali i Shpenzime Komunale	538,312.25

Tabela 5



2.6 Subvencione dhe Transfere

Pershkrimi	Shuma €
21200 - SUBVENCIONET PËR ENTITETET JOPUBLIKE	53,550.00
22110 - TRANSFERET PËR ENTITETET PUBLIKE	22,000.00
22115 - TRANSFERET PËR ENTITETET JOPUBLIKE	329,270.45
22202 - TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	623,299.48
22298 - PAGESAT PËR SHËRBIMET E VARRIMIT	159,665.00
22300 - VENDIMET GJYQËSORE	156.00
23130 - PAGESAT PËR KULTURAT BUJQËSORE	50,000.00
Totali i Subvencione dhe transfere	1,237,940.93

Tabela 6

2.7 Investime Kapitale

Pershkrimi	Shuma €
31121 - NDËRTESAT ARSIMORE	734,438.24
31122 - NDËRTESAT SHËNDETËSORE	492,749.12
31123 - OBJEKTET KULTURORE	217,173.70
31230 - RRUGËT LOKALE	1,951,849.09
31250 - RRJETET E KANALIZIMIT	50,000.00
31260 - RRJETET E UJËSJELLËSIT	8,282.89
31660 - PAJISJET MJEKËSORE	179,200.00
32110 - SHITRETËRIT E LUMENJVE	50,000.00
34000 - PAGESAT SIPAS VENDIMEVE GJYQËSORE	3,225,955.64
Totali i Investime Kapitale	6,909,648.68

Tabela 7



3. Shpalosja e shpenzimeve sipas programeve/nëprogrameve në kategori ekonomike

Nr	Drejtoria	Kategoria Ekonomike	Buxheti	Realizimi	% Realizimit
1	Zyra e Kryetarit	Paga dhe Meditje	227,042.46	227,042.46	100%
		Mallra dhe Shërbime	30,000.00	26,344.79	88%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			257,042.46	253,387.25	99%
2	Auditorët e Brendshëm	Paga dhe Meditje	41,407.08	41,407.08	100%
		Mallra dhe Shërbime	18,000.00	17,446.69	97%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			59,407.08	58,853.77	99%
3	Administrata	Paga dhe Meditje	385,004.22	385,004.22	100%
		Mallra dhe Shërbime	505,442.00	422,519.92	84%
		Shpenzime Komunale	101,600.00	85,998.87	85%
		Subvencione	155,000.00	154,980.00	100%
		Investime Kapitale	57,663.04	47,323.53	82%
TOTALI			1,204,709.26	1,095,826.54	91%
4	Çështja Gjimore	Paga dhe Meditje	20,871.60	20,871.60	100%
		Mallra dhe Shërbime	6,500.00	6,397.08	98%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	20,000.00	5,000.00	25%
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			47,371.60	32,268.68	68%
5	Integrime Evropiane	Paga dhe Meditje	64,219.63	64,219.63	100%
		Mallra dhe Shërbime	50,000.00	43,915.89	88%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	120,000.00	107,750.00	90%
		Investime Kapitale	70,000.00	63,923.91	91%
TOTALI			304,219.63	279,809.43	92%
6	Inspeksioni	Paga dhe Meditje	199,434.64	199,434.64	100%
		Mallra dhe Shërbime	90,000.00	72,663.17	81%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			289,434.64	272,097.81	94%



7	Zyra e Kuvendit Komunal	Paga dhe Meditje	323,247.60	323,247.60	100%
		Mallra dhe Shërbime	12,000.00	7,837.89	65%
		Shpenzime Komunale		-	#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			335,247.60	331,085.49	99%
8	Financa dhe Zhvillim Ekonomik	Paga dhe Meditje	190,665.55	190,665.55	100%
		Mallra dhe Shërbime	505,010.94	446,121.96	88%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	16.09	-	0%
TOTALI			695,692.58	636,787.51	92%
9	Shërbimet e Zjarrfikësve	Paga dhe Meditje	281,196.88	281,196.88	100%
		Mallra dhe Shërbime	80,000.00	59,129.32	74%
		Shpenzime Komunale	8,000.00	4,477.36	56%
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	20,000.00	20,000.00	100%
TOTALI			389,196.88	364,803.56	94%
10	Menaxhimi Fatkeqësive Natyrore	Paga dhe Meditje	35,650.81	35,650.81	100%
		Mallra dhe Shërbime	346,798.00	345,794.62	100%
		Shpenzime Komunale		-	#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			382,448.81	381,445.43	100%
11	ZLKK	Paga dhe Meditje	48,539.75	48,539.75	100%
		Mallra dhe Shërbime	15,000.00	8,296.00	55%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	15,000.00	13,609.00	91%
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			78,539.75	70,444.75	90%
12	Bujqësia	Paga dhe Meditje	84,467.44	84,467.44	100%
		Mallra dhe Shërbime	20,000.00	17,611.00	88%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	179,773.45	116,777.65	65%
		Investime Kapitale	22.83	-	0%
TOTALI			284,263.72	218,856.09	77%
13	Pylltari dhe Inspeksion	Paga dhe Meditje	63,564.95	63,564.95	100%
		Mallra dhe Shërbime	20,000.00	18,003.50	90%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	20,000.00	20,000.00	100%
		Investime Kapitale	24,703.52	-	0%
TOTALI			128,268.47	101,568.45	79%



14	Zhvillim Ekonomik	Paga dhe Meditje	95,757.67	95,757.67	100%
		Mallra dhe Shërbime	1,063,081.00	944,679.21	89%
		Shpenzime Komunale	151,000.00	138,230.83	92%
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale	4,562,898.22	3,534,310.88	77%
TOTALI			5,872,736.89	4,712,978.59	80%
15	Gjeodezi dhe Kadastër	Paga dhe Meditje	114,394.96	114,394.96	100%
		Mallra dhe Shërbime	15,000.00	10,049.89	67%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			129,394.96	124,444.85	96%
16	Planifikim Hapsinor dhe Rregullativ	Paga dhe Meditje	136,784.75	136,784.75	100%
		Mallra dhe Shërbime	100,000.00	94,771.41	95%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			236,784.75	231,556.16	98%
17	Administrata Shëndetësi	Paga dhe Meditje	41,950.25	41,950.25	100%
		Mallra dhe Shërbime	100,000.00	56,440.88	56%
		Shpenzime Komunale			#DIV/0!
		Subvencione	80,000.00	80,000.00	100%
		Investime Kapitale	679,305.00	671,949.12	99%
TOTALI			901,255.25	850,340.25	94%
18	QKMF	Paga dhe Meditje	2,820,949.62	2,820,949.62	100%
		Mallra dhe Shërbime	808,132.00	801,485.87	99%
		Shpenzime Komunale	86,400.00	84,466.59	98%
		Subvencione			#DIV/0!
		Investime Kapitale			#DIV/0!
TOTALI			3,715,481.62	3,706,902.08	100%
19	Mirëqenia Sociale	Paga dhe Meditje	213,866.49	213,866.49	100%
		Mallra dhe Shërbime	30,000.00	25,716.93	86%
